




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPKI  
 Nr. Prot. 06-476/20  
 Nr. Prot. 02  
 Data 25-02-2020



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparag. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparag. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 21.02.2020, mori:

### V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI-06-2849/19*, për zyrtarën e lartë znj. Vjosa Hamiti, Anëtare e Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarën e lartë publike znj. Hamiti, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi që është identifikuar se zyrtarja e lartë znj. Hamiti, Anëtare e Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, njëkohësisht është edhe person i autorizuar në bizneset private: “Vjosa Hamiti Krasniqi” B.I. (Klinika Stomatologjike “Identity”), “ZEIS” SH.P.K. dhe “Newco Dubrava Livestock Dairy Farm L.L.C”.

Agjencia kundër Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me qëllim të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesit ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), sigurimin e informatave për bizneset në fjalë. Nga informatat për biznese të pranuar prej ARBK-së (DPKI-06-2388-1/19), është konstatuar se zyrtarja e i lartë znj. Hamiti, është person i autorizuar në bizneset e sipërshënuara.

Agjencia, me shkresën zyrtare DPKI-06-152/20, e ka njoftuar zyrtarën e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar një takim



me zyrtaren e lartë në zyrat e Agjencisë, me ç'rast znj. Hamiti është njoftuar me faktet që posedon Agjencia.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë person i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku përcaktohet se:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.*

Zyrtarja e lartë znj. Hamiti, përmes shkresës sqaruese me shkrim të dorëzuar në Agjenci dhe gjatë takimit të mbajtur, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë. Por, ka deklaruar se nuk e ka ditur që kjo situatë paraqet konflikt të interesit, njëherit ka premtuar se menjëherë do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmangë gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën (DPKI-06-152-1/20) me të cilën dëshmohet se zyrtarja e lartë ka parashtruar Deklaratën për paraqitjen e dorëheqjes së parevokueshme nga pozita e Anëtarit të Kuvendit Komunal, pranë Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Prishtinës. Për më tepër, dorëheqja e znj. Hamiti nga funksioni publik është konfirmuar edhe nga Drejtorja e Administratës – Shërbimi i Kuvendit në Komunën e Prishtinës dhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Pas analizimit të dokumentacionit të pranuar nga zyrtarja e lartë dhe konfirmimeve të pranuar nga institucionet e sipërpërmenduar, Agjencia konstatoi se zyrtarja e lartë znj. Hamiti, ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga funksioni publik, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënpar. 1.4 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtarja e lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Hayolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

